



BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.28 datë 23.12.2014

PËR

**“MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2015-2017 DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2015”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 19 pikat 1-8 dhe nenit 32, gërma “dh” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit nr.7776, datë 22.12.1993 për “Buxhetin lokal” (i ndryshuar); udhëzimit 7, datë 28.02.2014 për “Përgatitjen e programit buxhetor afatmesem 2015-2017”; udhëzimit 7/1, datë 28.02.2014 për “Përgatitjen buxhetit vendor”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë Programin Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2015-2017 si më poshtë vijon.

1.1 Plani i të ardhurave të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2015-2017, është në shumat si më poshtë:

Plani i të ardhurave	<i>Në lekë</i>		
	2015	2016	2017
Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore	7.176.182.000	7.316.187.000	7.408.754.000
- Të ardhura tatimore	5.034.282.000	5.112.217.000	5.186.634.000
- Të ardhura jo tatimore	2.141.900.000	2.203.970.000	2.222.120.000
Të ardhura të trashëguara	250.000.000	250.000.000	250.000.000
Të ardhura nga transferta e pakushtëzuar	1.115.974.396	1.131.598.037	1.147.440.410
Totali	8.542.156.396	8.697.785.037	8.806.194.410

1.2 Plani i shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës Tiranës për periudhën 2015-2017, është në shumat si më poshtë:

Plani i shpenzimeve	<i>Në lekë</i>		
	2015	2016	2017
Shpenzime korrente	5.163.430.396	5.247.785.037	5.306.194.410
Shpenzime kapitale	3.378.726.000	3.450.000.000	3.500.000.000
Totali	8.542.156.396	8.697.785.037	8.806.194.410

2. Të miratojë detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015 si më poshtë:
 - 2.1 Të miratojë planin e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës sipas Pasqyrës Nr.1, pjesë përbërëse të këtij vendimi.
 - 2.2 Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë së Tiranës, Njësive Bashkiake si dhe çdo institucioni dhe ndërmarrje të varësisë sipas pasqyrës Nr.2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - 2.3 Të miratojë detajimin e buxhetit të shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës sipas Pasqyrave Nr.3, Nr.3/1 pjesë përbërëse të këtij vendimi.
 - 2.4 Të miratojë planin e shpenzimeve kapitale sipas programeve si në Pasqyrën Nr.4 pjesë përbërëse të këtij vendimi.
 - 2.5 Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik të kryejë avancim të fondeve mujore sipas realizimit të të ardhurave për vitin 2015.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Investimeve të Huaja, Drejtoria e Prokurimeve, Njësitë Bashkiake dhe të gjitha Institucionet dhe Ndërmarrjet në varësi të Bashkisë së Tiranës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI